



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 686/ 5 prot.

Datë 11.03.2026

V E N D I M
Nr. 377 /2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 11.03.2026 me:

Objekt: Mbylljen e çështjes për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “NISATEL” ShPK mbi modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*” Shërbime, me Nr. REF-77323-02-24-2026, me objekt “Shërbim Interneti dhe Telefon, për Bashkinë Vlorë dhe Institucionet në varësi” me fond limit 1.333.333 Lekë pa TVSH, për tu zhvilluar me datë 12.03.2026 nga autoriteti kontraktor Bashkia Vlorë.

Mbylljen e çështjes për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “VODAFONE ALBANIA” ShA mbi modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit sipërcituar.

Ankimues: Operatori ekonomik “NISATEL” ShPK me NIPT K26330201T, Adresa: *Lagjja Pavarësia Kulla I, Rrethi Skelë kati 2, Vlorë.*

Operatori ekonomik “VODAFONE ALBANIA” ShA me NIPT K11715005L, Adresa: *Autostrada Tiranë-Durrës, Rr. Pavaresia, Nr.61, Kasha Tiranë.*

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Vlorë.
Adresa: Sheshi “4 Heronjtë”, Rruga “Osman Haxhiu” Vlorë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për

miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues, informacionin e autoritetit kontraktor dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetura në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi, se ankesat e operatorëve ekonomikë janë paraqitur për të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.4. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

I.5. Operatorët ekonomikë ankimues, kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 25.02.2026 është publikuar, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit, “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar” Shërbime, me Nr. REF-77323-02-24-2026, me objekt “Shërbim Interneti dhe Telefon, për Bashkinë Vlorë dhe Institucionet në varësi” me fond limit 1.333.333 Lekë pa TVSH, për tu zhvilluar me datë 12.03.2026 nga autoriteti kontraktor Bashkia Vlorë.

II.2. Njëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kontraktor, është depozituar ankesa me numër ankimimi elektronik A/2026/6384, datë 03.03.2026 dhe me Nr. 686/2026 Prot., date 03.03.2026, nga operatori ekonomik “NISATEL” ShPK, për procedurën e prokurimit sipërcituar.

II.3. Bazuar në nenin 112, pika 3 të ligjit 162/2020, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

Referuar ankesës, operatori ekonomik ngre pretendime mbi modifikime të shtojcës 9, të DST-së, së procedurës së prokurimit objekt ankimi.

II.4. Autoriteti Kontraktor ka përcjellë në sistem shkresën me nr. 4479/2 Prot., datë 04.03.2026, protokolluar me tonën me nr. 686/1, datë 05.03.2026, si edhe ardhur me shërbim postar e njëjta shkresë, protokolluar me tonën me nr. 686/2, datë 05.03.2026, me objekt: “Vendim nr. 4479/1 prot., datë 04.03.2026, i KSHA-së lidhur me ankesën e “NISATEL” ShPK, me Nr. 686/2026 Prot, datë 03.03.02026, drejtuar KPP-së dhe Operatorit ekonomik ankimues.

Referuar Vendimit të KSHA-së, Autoriteti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës.

II.5. Njëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimimi elektronik A/2026/6388, datë 04.03.2026 dhe me Nr. 705/2026 Prot., date 05.03.2026, nga operatori ekonomik “VODAFONE ALBANIA” ShA, për procedurën e prokurimit sipërcituar.

II.6. Bazuar në nenin 112, pika 3 të ligjit 162/2020, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

Referuar ankesës, operatori ekonomik ngre pretendime mbi modifikime të shtojcës 9, të DST-së, së procedurës së prokurimit objekt ankimi.

II.7. Autoriteti Kontraktor ka përcjellë në sistem, shkresën me nr. 4591 Prot., datë 06.03.2026, protokolluar me tonën me nr. 705/1, datë 11.03.2026, me objekt: “Vendim lidhur me ankesën me Nr. 705/2026 Prot”, datë 05.03.02026, drejtuar KPP-së dhe Operatorit ekonomik ankimues.

Referuar Vendimit të KSHA-së, Autoriteti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës.

III

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, për modifikim të dokumenteve standarde të tenderit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se, Operatori ekonomik “NISATEL” ShPK argumenton në ankesën e tij modifikimin e kriterëve të procedurës e prokurimit sipërcituar, me pretendimet si vijon:

[...]Autoriteti Kontraktor (AK) nuk ka argumentuar vendosjen e kriteri 2.3.2. duke mos paraqitur asnjë arsytim ligjor apo teknik lidhur me përcaktimin e afatit 3 (tre) mujor të punësimit. Në **pikën 2.3.2(a)** kërkohet që OE të disponojnë 3 specialistë të certifikuar ITIL. Ndërkohë, në të njëjtën pikë është përcaktuar që këta punonjës duhet të jenë të punësuar pranë operatorit ekonomik për një periudhë 3 (tre) mujore, pa u specifikuar qartë momenti nga i cili fillon llogaritja e kësaj periudhe (nga data e publikimit të procedurës apo nga data e zhvillimit të saj).

Në mungesë të një argumentimi të qartë dhe të dokumentuar, ky kriter rezulton i paarsyetuar dhe joproportional. **Është e mjaftueshme që operatori ekonomik të dëshmojë punësimin e tyre të paktën për muajin e fundit nga data e publikimit të procedurës së prokurimit.**

ITIL është një standard për menaxhimin e shërbimeve IT (IT Service Management ITSM), por një kontratë për ofrimin e shërbimit të internetit ka në thelb: sigurimin e kapacitetit të bandës (bandwidth), ? garantimin e disponueshmërisë së shërbimit (uptime), respektimin e parametrave të SLA, monitorimin dhe sigurinë e trafikut.

Këto elementë lidhen kryesisht me infrastrukturën e rrjetit, kapacitetet teknike të operatorit dhe sistemet e monitorimit, dhe jo domosdoshmërisht me posedimin e 3 specialistëve të certifikuar ITIL.

Për sa më sipër, kërkojmë:

1. Modifikimin e kriterit kualifikues të përcaktuar në **pikën 2.3.2** Kapaciteti teknik , duke përcaktuar që punonjësit të jenë të punësuar pranë operatorit ekonomik ofertues për një periudhë minimalisht 1 (një) muaj nga data e publikimit të procedurës së prokurimit;

2. **Hegjen e pikës 2.3.2(a): 3 (tre) specialistë të certifikuar nga ITIL** për menaxhimin e shërbimeve të IT, ose ekuivalent , si kriter joproportional, i paargumentuar dhe kufizues i konkurrencës. Në mungesë të një argumentimi teknik dhe ligjor të dokumentuar nga AK, ky kriter përbën shkelje të parimeve themelore të prokurimit publik dhe cenon konkurrencën e lirë në treg.

III.1.1. Autoriteti kontraktor me Vendimin e KSHA-së ka vendosur pranimin e ankesës si vijon:

[...]Në **pikën 2.3.2(a)** kërkohet që OE të disponojnë 3 specialistë të certifikuar ITIL. Ndërkohë, në të njëjtën pikë është përcaktuar që këta punonjës duhet të jenë të punësuar pranë operatorit ekonomik për një periudhë 3 (tre) mujore, pa u specifikuar qartë momenti nga i cili fillon llogaritja e kësaj periudhe (nga data e publikimit të procedurës apo nga data e zhvillimit të saj).

Në mungesë të një argumentimi të qartë dhe të dokumentuar, ky kriter rezulton i paarsyetuar dhe joproportional. **Është e mjaftueshme që operatori ekonomik të dëshmojë punësimin e tyre të paktën për muajin e fundit nga data e publikimit të procedurës së prokurimit.**

1. Në lidhje me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik mbi kërkesën për disponimin e specialistëve të certifikuar ITIL, ju sqarojmë:

Ankesa juaj pranohet dhe hiqet si pika 2.3.2 (a) kërkohej që OE të disponojnë 3 specialistë të certifikuar ITIL, e vendosur nga komisioni i hartimit të kriterëve të përgjithshme

2. Në lidhje me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik mbi kërkesën që punonjësit duhet të jenë të punësuar pranë operatorit ekonomik për një periudhë 3 (tre) mujore,

PIKA 2.3.2 Operatori ekonomik duhet të ketë një numër prej mesatarisht 3 (tre) punonjës të siguruar 3 (tre) muajt e fundit, si dhe gjatë vlefshmërisë së kontratës, ku përfshihet një personel teknik i diplomuar në degët e Inxhinierive Informatike (IT) që do të angazhohen në implementimin e mirëmbajtjes, si më poshtë:

a. 3 (tre) specialistë të certifikuar nga ITIL për menaxhimin e shërbimeve të IT, ose ekuivalent

Për të vërtetuar stafin e mësipërm operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Deklaratë për disponimin e punonjësve të përmendur në këtë pikë
- Certifikata përkatëse/ Transkriptet përkatëse
- Listëpagesat sipas formularit E-Sig 025/a për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruara sipas legjisllacionit në fuqi.

- Kontrata pune, për secilin nga punonjësit e përmendur në këtë pikë, të vlefshme gjatë periudhës së vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër.

Ne si Komision i Shqyrtimit të Ankesës e heqim pikën 2.3.2.

VENDOSI:

1. Të pranojë ankesën duke reflektuar dhe ndryshuar pikat përkatëse sipas ankesës së ardhur, duke dalë me shtojcë përfundimtare.

2. Në përmblyllje, vlerësojmë se pretendimet e ngritura nga operatori NISATEL, qëndrojnë.

III.1.2. Neni 30 i LPP-së parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera.*

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar, i cili parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik: a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

III.1.4. Përsa më sipër konstatohet, se autoriteti kontraktor ka pranuar plotësisht ankesën e operatorit ekonomik ankimues NISATEL ShPK, mbi modifikim të shtojcës 9, në procedurën e prokurimit sipërcituar, duke përmbushur qëllimin e ankimuesit.

Komisioni, në mbështetje të neneve 30, 115, pika 1 dhe 3 dhe 118 dhe të ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, do të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues NISATEL ShPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar” Shërbime, me Nr. REF-77323-02-24-2026, me objekt “Shërbim Interneti dhe Telefon, për Bashkinë Vlorë dhe Institucionet në varësi” me fond limit 1.333.333 Lekë pa TVSH, për tu zhvilluar me datë 12.03.2026 nga autoriteti kontraktor Bashkia Vlorë.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, për modifikim të dokumenteve standarde të tenderit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se, Operatori ekonomik “VODAFONE ALBANIA” ShA argumenton në ankesën e tij modifikimin e kriterëve në procedurën e prokurimit sipërcituar, me pretendimet si vijon:

[...] Në cilësinë e operatorit të interesuar për të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi zhvilluar nga Autoriteti Kontraktor, paraqesim këtë ankesë lidhur me kriterin e përcaktuar në **pikën 2.3.2** të dokumenteve të tenderit, i cili parashikon se:

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të ketë një numër prej mesatarisht 3 (tre) punonjës të siguruar 3 (tre) muajt e fundit, si dhe gjatë vlefshmërisë së kontratës, ku përfshihet një personel teknik i diplomuar në degët e Inxhinierive Informatike (IT) që do të angazhohen në implementimin e mirëmbajtjes, si më poshtë: a. 3 (tre) specialistë të certifikuar nga ITIL për menaxhimin e shërbimeve të IT, ose ekuivalent vlerësojmë se kjo kërkesë është joproportionale dhe nuk lidhet drejtpërdrejt me objektin e kontratës. Nga analiza e specifikimeve teknike rezulton se objekti i kontratës konsiston në ofrimin e linjave të dedikuara interneti (DIA), linjave standarde me IP statike, linjë backup përmes rrjetit celular 4G/5G dhe shërbim telefonie fikse, të shoqëruara me parametra të qartë teknike si

disponueshmëria (SLA), latency, packet loss, jitter, kohë reagimi dhe penalitete në rast mosrespektimi. Në asnjë pjesë të dokumentacionit nuk kërkohet implementim i proceseve të menaxhimit të shërbimeve IT apo transformim organizativ sipas praktikave të ITIL. ITIL përbën një framework ndërkombëtar për menaxhimin e shërbimeve IT (IT Service

Ky kriter krijon një barrierë të panevojshme për pjesëmarrjen në procedurë duke kufizuar konkurrencën. Cilësia e shërbimit në këtë rast garantohet përmes parametrave të matshëm teknikë dhe penaliteteve të përcaktuara në SLA, jo përmes numrit të certifikimeve ITIL të stafit. Në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe të konkurrencës së lirë në prokurimin publik na zbatim të nenit 3 dhe nenit 77, pika 1 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 Per prokurimin publik , i ndryshuar, kriteret e kualifikimit duhet të jenë të domosdoshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Në këtë kuadër, kërkesa për 3 specialistë të certifikuar ITIL nuk përmbush kriterin e domosdoshmërisë dhe rezulton e pajustificuar në raport me shërbimin e kërkuar.

Për sa më sipër, kërkojmë heqjen e kriterit 2.3.2, si kriter që nuk është proporcional, nuk lidhet drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe kufizon në mënyrë të pajustificuar konkurrencën.

III.2.1. Autoriteti kontraktor me Vendimin e KSHA-së ka vendosur pranimin e ankesës, argumentuar:

[...] ***Kritei 2.3.2.*** Operatori ekonomik duhet të ketë një numër prej mesatarisht 3 (tre) punonjës të siguruar 3 (tre) muajt e fundit, si dhe gjatë vlefshmërisë së kontrates, ku përfshihet një personel teknik i diplomuar në degët e Inxhinierive Informatike (IT) që do të angazhohen në implementimin e mirëmbajtjes, si më poshtë: a. 3 (tre) specialistë të certifikuar nga ITIL për menaxhimin e shërbimeve të IT, ose ekuivalent. Vlerësojmë se kjo kërkesë është joproporcionale dhe nuk lidhet drejtpërdrejt me objektin e kontratës

Kërkojmë heqjen e kriterit 2.3.2, si kriter që nuk është proporcional, nuk lidhet drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe kufizon në mënyrë të pajustificuar konkurrencën.

1. Në lidhje me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik mbi kërkesën për disponimin e specialistëve të certifikuar ITIL, ju sqarojmë:

Nga shqyrtimi i kriterit mbi kërkesën për disponimin e tre specialistëve të certifikuar nga ITIL, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave arsyeton se ankesa juaj në lidhje me kriterin 2.3.2 a) e kriterëve të veçantë të kualifikimit, e vendosur nga komisioni i hartimit të kriterëve, ankesa qendron dhe vendos të heqë kriterin.

Ne përfundim Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës,

VENDOSI:

1. Të pranojë ankesën duke reflektuar dhe ndryshuar pikat përkatëse sipas ankesës së ardhur, duke dalë me shtojcë përfundimtare.

2. Në përmbyllje, vlerësojmë se pretendimet e ngritura nga operatori VODAFONE ALBANIA S.H.A, qëndrojnë.

III.2.2. Neni 30 i LPP-së parashikon shprehimisht se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të

nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.

III.2.3. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar, i cili parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik: a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

III.2.4. Përsa më sipër konstatohet, se autoriteti kontraktor ka pranuar plotësisht ankesën e operatorit ekonomik ankimues *VODAFONE ALBANIA S.H.A.*, mbi modifikim të shtojcës 9, në procedurën e prokurimit sipërcituar, duke përmbushur qëllimin e ankimuesit.

Komisioni, në mbështetje të neneve 30, 115, pika 1 dhe 3 dhe 118 dhe të ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, do të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues *VODAFONE ALBANIA S.H.A.*, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar” Shërbime, me Nr. REF-77323-02-24-2026, me objekt “Shërbim Interneti dhe Telefon, për Bashkinë Vlorë dhe Institucionet në varësi” me fond limit 1.333.333 Lekë pa TVSH, për tu zhvilluar me datë 12.03.2026 nga autoriteti kontraktor Bashkia Vlorë.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, 115, pika 1 dhe 3 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të

Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mbyllë çështjen për ankesën e operatorit ekonomik NISATEL ShPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar” Shërbime, me Nr. REF-77323-02-24-2026, me objekt “Shërbim Interneti dhe Telefon, për Bashkinë Vlorë dhe Institucionet në varësi” me fond limit 1.333.333 Lekë pa TVSH, për tu zhvilluar me datë 12.03.2026 nga autoriteti kontraktor Bashkia Vlorë.
2. Të mbyllë çështjen për ankesën e operatorit ekonomik VODAFONE ALBANIA ShA për procedurën e prokurimit sipërcituar.
3. Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentet e procedurës së prokurimit duke përpiluar shtojcën sipas vendimmarjes së KSHA-së dhe publikuar në SPE.
4. Autoriteti Kontraktor brenda 5 ditëve të njoftojë KPP-në mbi veprimet e ndërmarra në përputhje me konstatimet e këtij vendimi.
5. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifëve financiare të paguara nga operatorët ekonomikë “NISATEL ShPK” dhe “VODAFONE ALBANIA ShA.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar

Gjergj Mersini

Anëtar

Anila Malaj

Nënkryetar

Fiorent Zguro

